



Republika e Maqedonisë së Veriut



Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore
Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup

Në bazë të nenit 19, paragrafi 2, pika 11 dhe nenit 19-a nga Ligji për ndërmarrje publike, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/96, 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18 dhe 35/19) dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 275/19), nenit 26 nga Statuti i Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup dhe Vendimit nr. 0201- 3700/6 të miratuar më 11.06.2021 nga Bordi drejtues për shpalljen e konkursit publik për zgjedhje të zëvendës drejtorit, Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup shpall

KONKURS PUBLIK

për zgjedhje të zëvendës drejtorit të Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore,
"Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup

- I. Kandidatët që do të aplikojnë në konkursin publik për zëvendës drejtor duhet t'i plotësojnë kushtet në pajtim me ligjin dhe aktet e Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup, edhe atë:
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
 - të ketë marrë më së paku 240 kredi sipas Sistemit evropian të transferimit të kredisë ose të ketë mbaruar shkallën e VII/1 të arsimimit, edhe atë: Fakultetin e Komunikacionit, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Fakultetin Elektroteknik, Fakultetin e Ndërtimtarisë, Fakultetin Juridik, Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Administratës Publike dhe Shkenca Politike ose Fakultetin e Informatikës;
 - në momentin e emërimit me aktvendim gjyqësor fuqiplotë të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion ndalesë për realizimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - të ketë më së paku pesë vite përvojë pune;
 - ta njohë mirë gjuhën angleze.

II. Kandidatët gjatë aplikimit duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Certifikatë të shtetësisë;
- Vërtetim nga organi kompetent se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion ndalesë për realizimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Biografi të shkurtë – CV;
- Letër motivimi për aplikim në konkurs;
- Certifikatë për mbarimin e arsimimit të lartë;
- Vërtetim për përvojë pune (historia për lëvizje të vendeve të punës nga APRMV ose listë nga FSPIMV);
- Të posedojë një nga këto certifikata të njohura ndërkombëtare ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, edhe atë: TOEFL iBT – më së paku 74 pikë, IELTS – më së paku 6 pikë, (ILEC Cambridge English: Legal) - më së paku nivelin e (B2) , (FCE Cambridge English: First) – të kaluar, (BULATS) – më së paku 60 pikë ose (APTIS) – më së paku nivelin e (B2);
- Plan dhe program për punë në Ndërmarrjen Publike për 4(katër) vitet e ardhshme.

III. Zëvendës drejtori i Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut" –Shkup zgjidhet me mandat prej 4 viteve.

IV. Kohëzgjatja e shpalljes është 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit publik në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të bëhet në afat të konfirmuar me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Statutin e Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup.

V. Njoftimi për zgjedhjen e realizuar të kandidatëve do të bëhet me shkrim pas miratimit të Vendimit të zgjedhjes nga Bordi drejtues i Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut"- Shkup.

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë me dorëzimin e aplikacionit me dokumentacionin e duhur në një zarf të mbyllur në adresën: Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut" –Shkup, rr. "Jordan Mijallkov" nr. 50b - 1000 Shkup ose në Arkivin e Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup, me mbishkrim "Për konkursin publik për zgjedhje të zëvendës drejtorit".

Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në formën origjinale ose kopje të verifikuara në noter.

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit. Dokumentet e pranuar do t'i kontrollojë komisioni tre anëtarësh i zgjedhur nga Bordi drejtues i Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut" – Shkup.

Në afat prej 8 (tetë) ditësh pas skadimit të afatit të konkursit, komisioni tre-anëtarësh dokumentacionin e plotë me informatë e dorëzon te Bordi drejtues i Ndërmarrjes. Dokumentacioni jo i plotë dhe i cili nuk është dorëzuar në kohë nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimeve.

Bordi drejtues i Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup